

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANE

Nr. 129 AKTI

DT.22.02.2017

V E N D I M
NE EMER TE REPUBLIKES
Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, e perbere prej:

GJYQTAR: ARBEN MICKAJ

Asistuar prej sekretares **Merita Kuci(Drishti)**, pas shqyrtimit ne seance gjyqësore me dyer te hapura, sot me datë **22 Shkurt 2017**, lidhur për çështjen penale me Nr. 129 Akti dhe date ardhje 18.11.2016, e qe i perket:

K E R K U E S: **P. A.P. A., i biri i Gj. dhe i D., i dtl. 19.01.19.., lindur ne Fush-Arrez dhe banues në Tirane, Blv.”...”, pall.64, shk.2, hyrja 2, me shtetësi kombësi shqiptar, mbrojtur ne gjykim nga Av. Eduart Mullaraj me nr.5783 license dhe NIPT L 41313063T.**

PERSON NË GJYKIM: **Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë**
përfaqësuar nga prokurori **Ndini Tavani**.

O B J E K T I: Heqje e sekuestros te sendeve personale te te denuarit P. A.P. A..

BAZA LIGJORE: Nenet 274, 275 të K.Pr.Penale.

Gjykata, si dëgjoi perfaqsesin e kërkesit P. A.P. A., Av.Eduart Mullaraj i cili hoqi dorë nga gjykimi duke kërkuar pushimin e gjykimit të çështjes, prokurorin Ndini Tavani , i cili kërkoi pushimin e gjykimit dhe pasi shqyrtoi aktet e bisedoi çështjen;

V Ë R E N

Se nga kërkesi P. A.P. A. më datë 18.11.2016 është depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesa me objekt heqje mase sekuestro te sendeve personale te te denuarit P. A..

Rezultoi ne gjykim, se kërkuesi P. A., në seancën gjyqësore të datës 22.02.2017 deklaroi se hiqte dorë nga gjykimi i kërkesës (ankimit) duke kërkuar pushimin e gjykimit të çështjes, (për më hollësisht shih proçes-verbalin e seancës). Në gjykim u paraqit organi i prokurorisë përfaqësuar nga prokurori Ndini Tavani, i cili ishte dakort me pushimin e gjykimit të çështjes penale.

Ndodhur në këto kushte gjykata çmon se nuk duhet proçeduar më tej.Sa me sipër, gjykata çmon se nuk duhet proçeduar me tej dhe:

Në referim të nenit 387 te K.Pr.Penale,

V E N D O S I

- I. Pushimin e kerkeses penale me Nr. 129 Akti dhe date ardhje 18.11.2016, me kerkues **P. Gj. A.**, me objekt “Heqje mase sekuestroje”.
- II. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohet kërkuesit.
- III. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, sipas ligjit.
- **U shpall sot në Tiranë, më datë 22 Shkurt 2017.**

S E K R E T A R E

G J Y Q T A R

Merita Kuci(Drishti)

ARBEN MICKAJ